



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština – Municipality of Prishtina**



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, të Ligjit nr. 03/ L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 04.09.2023, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR GRAN FEST – KOSOVA**

**I.**

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për **GRAN Fest – Kosova**.

**II.**

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 15,500.00€ (pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve - Drejtoria e Administratës.

**III.**

Qëllimi i këtij Vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II, për **GRAN Fest – Kosova**, festival ndërkombëtar i romanit grafik.

**IV.**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

**V.**

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
**01-400/04-183770/23, më 05.09.2023**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Pëllumb Bajçinovci**

